



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38 244 473

e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

**RREGULLORE PËR KALIMIN E SPORTISTËVE NGA
KLUBI NË KLUB**

Prishtinë, 11.11.2022

Në bazë të Nenit 22, alineja 2.12 të Statutit të FSHSK-së (në tekstin e mëtejme – Statuti), pas hartimit të propozimeve për ndryshimin e Rregullores për kalimin e sportistëve nga klubi në klub, Këshilli Drejtues në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 11.11.2022, në Prishtinë, miraton këtë:

RREGULLORE PËR KALIMIN E SPORTISTËVE NGA

KLUBI NË KLUB

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore në mënyrë të veçantë rregullohen kushtet, procedurat dhe mënyrat e kalimit të shenjëtarëve nga njëri klubi në klubin tjetër të shenjëtarisë sportive, e drejta e shenjëtarëve për pjesëmarrje në garat në Kosovë, dhe kalimi i shenjëtarëve në klube jashtë vendit.

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen për të gjithë shenjëtaret aktiv te të gjitha moshave dhe të dy gjinitë (në tekstin e mëtejme si: shenjëtar) në Kosovë dhe janë të obligueshme për të gjitha organizatat e Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës (në tekstin e mëtejme FSHSK-së).

Organ Kompetent sipas kësaj Rregulloreje është Këshilli Drejtues, sipas Neni 16. të Statutit të FSHSK-së

Neni 2

Parimet themelore që përbëjnë bazën e kësaj rregulloreje janë:

- Shenjëtari me dëshirë zgjedh klubin për të cilin dëshiron të garoj,
- marrëdhëniet Shenjëtar-klub përcaktohen me kontratë dhe këtë rregullore dhe në mbulimin e kostos reale në relacion me shenjëtarin
- klubi amë ka të drejtë për kompensim.

Afati kalimtar

Neni 3.

Kalimi i shenjëtarit prej një klubi në klubin tjetër mund të bëhet vetëm në afatin kalimtar.

Neni 4

Afati kalimtar i rregullt zgjat prej 1 dhjetori deri më 31 dhjetor të vitit aktual dhe ndahet në katër (4) periudha:

- periudha e parë: **prej 1 deri 10 dhjetor** të vitit aktual kur Shenjëtari i dorëzon kërkesën klubit për lejim,
- periudha e dytë: **deri më 18 dhjetor** të vitit aktual në të cilën klubit të cilit i është bërë kërkesa për lejim është i obliguar që të përgjigjet në kërkesën e Shenjëtarit,
- Periudha e tretë: **prej 18 deri më 25 dhjetor** të vitit aktual, kur klubi medoemos duhet të paraqesë Komisionit për regjistrim të Shenjëtari të FSHSK-së, për miratimin e kalimit të shenjëtarit nga klubi në klub,
- Periudha e katërt: **prej 25 deri më 31 dhjetor** të vitit aktual, kur Komisioni për regjistrim të shenjëtari është i obliguar të lëshojë një vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për kalimin e shenjëtarit nga klubi në klub.

Çdo parashtrim që ka të bëjë me këtë nen duhet ti dorëzohet personalisht atij të cilit i drejtohet ose me postën me kthim me të cilën tregohet që dërgesa është bërë, ose në mënyrë personale me nënshkrim të pranuesit (personit zyrtar).

Afatet kohore do të llogariten në ditë.

Afati nuk përfshin ditën e dorëzimit kur është kryer dërgesa, por për fillim të afatit merret dita e nesërme.

Nëse dita e fundit e afatit bie në një festë publike apo ditë e diel, afati skadon në ditën e ardhshme.

Neni 5

Shenjëtari mund të bëjë kalimin prej klubi në një klub tjetër të shenjëtarisë sportive jashtë afatit kalimtar në rastet e mëposhtme:

- me fshirjen e klubit të shenjëtarisë sportive nga regjistri zyrtar i organit kompetent dhe zgjat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të ditës së parë të vendimit të organit kompetent;
- skadimi i periudhës ligjore të pushimit të lehonisë dhe zgjatë në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje, përveç se për fillim të afatit llogaritet kalimi i ditës së parë të përfundimit të periudhës ligjore të pushimit të lehonisë

Neni 6

Në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditën e diel apo në një festë publike ose ndonjë ditë tjetër kur klubi apo FSHSK nuk punon, afati kalon në ditën e ardhshme. Kjo vlen për të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje në të cilat u referohemi afateve.

Neni 7

Shenjëtari që dëshiron të ndërroj klubin në kuptim të nenit 4 ose nenit 5, paragrafit 2.3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, në afatin kalimtar duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për lëshim klubit në të cilin është anëtar. Kërkesa i referohet klubit amë, kurse kopja e kërkesës komisionit të regjistrimit të FSHSK-së me postë të regjistruar ose personalisht me verifikim dhe nënshkrim.

Përmbajtjen dhe formën e kërkesës e zgjedhë vet parashtruesi, përveç se është i obliguar që në kërkesë të shënoj klubin në të cilin kalon si dhe të dhënat personale: emrin, mbiemrin, adresën dhe vendin e banimit.

Si datë e aplikimit, llogaritet data e vulës postare të deponuar në postë apo nga data kur ia dorëzon kërkesën personit të autorizuar të klubit amë.

Neni 8.

Brenda afatit kalimtar shenjëtari mund të dorëzojë kërkesë për kalim vetëm në një klub. Po kështu, shenjëtari mund ta tërheqë kërkesën e tij për të kaluar në një klub të ri, në periudhën prej 01.-10.dhjetor të vitit aktual. Njoftimin me shkrim të tërheqjes së kërkesës për lëshim të i dorëzon klubit amë, klubit të ri dhe Komisionit për regjistrim të shenjëtarëve të FSHSK-së - me postë të regjistruar ose personalisht me verifikim dhe nënshkrim.

Si datë e tërheqjes së kërkesës, llogaritet data e vulës postare të deponuar në postë apo nga data kur ia dorëzon kërkesën personit të autorizuar të klubit amë apo klubit të ri.

Neni 9.

Shenjëtari, i cili afatin kalimtar të njëjtë e nënshkruan formularin e aplikimit ose kontratën për dy ose më shumë klube do ti nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore dhe mbetet i regjistruar për klubin me të cilën ai është regjistruar para afatit kalimtar.

Neni 10.

Kur klubi amë pranon kërkesën për dhënien e lëshimit, ai është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës brenda afatit të parashikuar në nenin 4. të paragrafit 2 të kësaj rregulloreje. Nëse të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë Rregullore janë plotësuar që klubi amë të lëshojë fletë lëshimin, kurse në të kundërtën ai do të refuzojë dhënien e fletë lëshimit, me arsyet dhe të drejtën e ankimit.

Neni 11.

Fletë lëshimin ose vendimi për refuzimin e kërkesës klubi amë është i obliguar ta dorëzojë, vetëm me postë rekomanduese ose personalisht me verifikim dhe nënshkrim për:

- parashtruesit të kërkesës - Shenjëtarit;
- klubit të cilit shenjëtari në kërkesë e ka quajtur si klub i ri (klubin ku do të kaloj);
- Komisionit të regjistrimit të FSHSK-së.

Formulari i fletëlëshimit është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Si datë e dhënies së fletë lëshimit llogaritet data e vulës postare e depozitimit të regjistruar ose data e verifikimit kur i dorëzohet atletit, klubit të ri dhe Komisionit të regjistrimit të shenjëtarëve të FSHSK-së.

Neni 12.

Klubi amë mund të refuzojë kërkesën për dhënie të fletë lëshimit në rastet e mëposhtme:

- Shenjëtari i cili është nën kontratë;
- Shenjëtari ndaj të cilit zhvillohen masat disiplinore ose masat që rrjedhin të sanksioneve disiplinore;
- Shenjëtari i cili në kërkesë nuk ka saktësuar klubin në të cilin kalon dhe të dhënat personale;
- Shenjëtari që është në pushim ligjor të lehonisë.

Neni 13.

Nëse klubi amë nuk i përgjigjet kërkesës për dhënie të fletëlëshimit të Shenjëtarit brenda afatit të parashikuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 të pikës 2 të kësaj rregulloreje do të konsiderohet se Shenjëtari ka marrë miratimin për të kaluar në një klub të ri.

Shenjëtari që merr pëlqimin në kuptim të paragrafit të mësipërm të këtij neni do të regjistrohet për një klub të ri.

Klubi nga i cili është Shenjëtari nuk ka të drejtë në kompensim.

Neni 14.

Shenjëtari i cili fare nuk ka marrë pjesë në garat e shenjëtarisë së paku 365 ditë (një vit) nga dita e pjesëmarrjes së fundit, me paraqitjen e kërkesës për kalim në klub të ri fiton të drejtën e regjistrimit për klubin e ri në aspektin e nenit 4, 7 dhe 13 të kësaj rregulloreje.

Shenjëtari i cili fare nuk ka marrë pjesë në garat e shenjëtarisë së paku 365 ditë (një vit) mundet gjithashtu të regjistrohet për një klub të ri në kuptim të regjistrimit të parë.

Periudha jo garuese nuk llogaritet:

- kur shenjëtari ka një kontratë të vlefshme;
- Shenjëtarit ndaj të cilit zhvillohen masat disiplinore ose masat që rrjedhin nga sanksionet disiplinore;
- Shenjëtari që është në pushim ligjor të lehonisë.

Neni 15.

Klubi amë nuk mund ta suspendoj Shenjëtarin as të fillojë procedurë disiplinore kundër tij për shkaqet e mëposhtme:

- kur Shenjëtarit i mbaron kontrata;
- pas aplikimit të kërkesës për kalim të shenjëtarit në një klub të ri;
- kur Shenjëtari është në pushim ligjor të lehonisë;
- pas skadimit të ditës 365 të mospjesëmarrjes në garat e shenjëtarisë.

Neni 16

Klubi i ri i parashtron kërkesë për miratimin e kalimit të shenjëtarëve të rinj Komisionit për regjistrim të FSHSK-së.

Kërkesa është në rregull, në qoftë se ajo është paraqitur në përputhje me nenin 4 të paragrafit 1 pika 3 të kësaj rregulloreje. Kërkesa duhet të paraqitet personalisht dhe dorëzimi duhet konfirmuar nga personi i autorizuar në FSHSK-së ose me postë me pranimin e kthimit të dëshmuar se kërkesa ishte dorëzuar.

Kërkesa duhet të shoqërohet me:

1. Listën e shenjëtarëve të rinj për të cilët kërkohet miratimi i kalimit;
2. Një fotokopje me formular të aplikimit të nënshkruar nga shenjëtari për klubin e ri (formulari origjinal dhe 2 foto të bashkangjitur për komisionin për regjistrim të FSHSK-së, pas miratimit nga ana e Komisionit);
3. Fletë lëshimi me ose pa sqarim;
4. Një vërtetim i bankës si dëshmi e pagesës së kompensimit sipas nenit 24, 25, dhe 26 të kësaj rregulloreje;
5. Një kopje të kërkesës për lëshim dhe pranimin postar origjinal të dërgesës së regjistruar, në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje;
6. Konfirmimi i klubit amë për pjesëmarrjen e fundit apo deklaratën personale të shenjëtarit, në bazë të materialit të plotë dhe përgjegjesisë personale, për shenjëtarët të cilët nuk kanë garuar për klubin amë për të paktën 365 ditë;
7. Vendimin e komisionit për regjistrim të FSHSK-së për vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve të ndërsjella të palëve kontraktuese;
8. Vendimin e autoriteteve kompetente për të hequr nga regjistri i autoritetit kompetent.

Si datë parashtrimi të kërkesës llogaritet data e vulën postare të depozitimit në postë të regjistruar ose datën e verifikimit pas pranimit nga komisioni i regjistrimit të atletëve të FAK-ut.

Neni 17.

Kur Komisioni për regjistrim i FSHSK-së pranon një kërkesë të rregullt për miratimin e kalimit të shenjëtarit në klub të ri, është e nevojshme për të marrë një vendim për miratimin e kërkesës përkalim, në kuptim të nenit 4 paragrafi 4 i kësaj rregulloreje.

Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, vendimin mbi aprovimin e kërkesës për kalim, e dorëzon vetëm me postë ose email: klubit të ri, klubit amë dhe shenjëtarit.

Nëse shenjëtari nuk është i regjistruar për klubin e ri të shenjëtarisë sportive, prej 30 ditë nga data e marrjes së vendimit, mbetet shenjëtar i paregjistruar për atë sezon ose anëtar i klubit amë.

Kontrata

Neni 18.

Kontratën mund ta realizojnë shenjëtari dhe klubi i shenjëtarisë sportive dhe kështu të përcaktojë të drejtat dhe obligimet përkatëse të klubit dhe shenjëtarit. Kontrata do të nënshkruhet nga personi i autorizuar klubit dhe shenjëtari nga ana tjetër.

Nëse në kohën e nënshkrimit të kontratës shenjëtari nuk është i moshës madhore, klubi duhet të nënshkruajë një kontratë me prindin ose kujdestarin e tij.

Neni 19

Kontrata përfshin pjesën kryesore dhe aneksin e kontratës. Kontrata bazë duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- të dhënat personale të palëve;
- kohëzgjatjen e kontratës;
- obligimet e shenjëtarit në aspektin e ekzekutimit të detyrave në pajtim me aktet normative të klubit dhe FSHSK-së;
- mënyra dhe kushtet në të cilat ata mund të ndërpresin kontratën.

Pjesa kryesore e kontratës duhet të jetë e vërtetuar nga ana e personit të autorizuar të FSHSK-së, dhe në rast të kontestit, kontrata e vlefshme duhet të jetë vetëm ajo e dorëzuar në FSHSK-së, kurse bëhet në 3 (tre) kopje identike, prej të cilave një (1) kopje i përket shenjëtarit, klubit, dhe një FSHSK-së.

Aneksi i kontratës është pjesë e marrëveshjes bazë dhe ka karakterin e një sekreti afarist dhe duhet të jetë më afër për të rregulluar marrëdhëniet e shenjëtarit dhe klubit. Aneksi i kontratës do t'i bashkëngjitet Komisionit për regjistrim të FSHSK-së, në rast të një mosmarrëveshje ndërmjet shenjëtarit dhe klubit.

Aneksi i kontratës duhet të saktësojë mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të garuesit (armën, aksesoret, uniformën, materialin shpenzues, shpenzimet e pjesëmarrjes në gara, etj).

Në rast se Aneksi i kontratës parasheh shumën e kërkuar për kompensim, në rast të kalimit në ndonjë KSH tjetër, kjo shumë nuk do të jetë më e lartë se ajo e përcaktuar sipas Nenit 25. Paragrafi 1.

Neni 20.

Kontrata mund të lidhet për një periudhë prej të paktën 2 (dy) dhe më së shumti 4 (katër) vjet – të sezonit garues.

Kontrata për 1 (një) vit mund të lidhin shenjëtarët të cilët në vitin e nënshkrimit të kontratës janë nën moshë 18 vjeçare.

Neni 21.

Me pëlqim të dyanshëm, kontrata mund të shkëputet para skadimit të kohës për të cilën është konstatuar (përfundimi i rënë dakord i kontratës). Ndërprerja e kontratës, e vërtetuar nga personi i autorizuar i FSHSK-së, duhet të bëhet në tre (3) kopje, nga të cilat një (1) i përket klubit amë, shenjëtarit dhe Komisioni për regjistrim të FSHSK-së.

Neni 22

Me kërkesë të shenjëtarit apo klubit kontrata mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme me vendim të Komisionit për regjistrim të FSHSK-së, në rast se shenjëtari apo klubi nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe aneks.

Me kërkesë është e nevojshme të dorëzohen të gjitha dëshmitë relevante që mund të kontribuojë për korrektësinë e vendimit të komisionit për regjistrim të FSHSK-së.

Si datë e deponimit të kërkesës, llogaritet data e vulës postare të depozitimit të regjistruar në postë ose data e vërtetimit nga klubi amë.

Neni 23.

Tema e diskutimit dhe vendimmarrjes së Komisionit për regjistrim të FSHSK-së, është vlerësimi i përmbushjes së detyrimeve reciproke në bazë të kontratës në përputhje me këtë rregullore. Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, është i detyruar të marrë një vendim me shkrim me një shpjegim për palët e interesuara.

Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, gjatë diskutimit dhe vendimmarrjes, duhet të shtjellojë edhe çështjen e mbulimit të shpenzimeve (koston reale), duke marr për bazë investimin kumulativ të KSH-së amë ndaj shenjëtarit, si dhe zhvlerësimin (amortizimin) e këtij investimi (p.sh. uniforma, arma, aksesorët, trajnimet, kampingjet, etj.). Bazë për përlllogaritjen financiare do të jenë pasqyrat financiare të KSH-së amë, të vërtetuara sipas rastit: nga Kontabilisti i certifikuar, nga Auditori i certifikuar, përkatësisht nga Departamenti i Sportit i MKRS-së.

Në kosto reale nuk llogaritet kompensimi në formën e mëditjeve, pagës, shpërblimeve, apo formave tjera të stimulimit të drejtpërdrejtë

Mbulimi i shpenzimeve dhe kompensimi

Neni 24.

Klubi i ri në të cilin kalon shenjëtari, është i obliguar që të paguajë kompensim për klubin amë ngai cili shenjëtari shkon, nëse kjo është paraparë në Kontratë.

KSH i ri në të cilin kalon shenjëtari, është i obliguar që të paguaj koston reale të KSH amë në relacion me shenjëtarin, sipas Neni 23. Paragrafi 2, përpos nëse KSH amë heq dorë nga ky kusht.

Klubi i ri është i obliguar të paguajë kompensim dhe koston reale në llogarinë e klubit amë jo më vonë se data e aplikimit te Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, brenda kuptimit të neni 4, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 25.

Këshilli drejtues i FSHSK-së, vendos për shumën maksimale të kompensimit për kategori të caktuara të atletëve. Shuma e kompensimit, si dhe kategorinë e shenjëtarit, këshilli drejtues i FSHSK-së, është i obliguar ta publikojë pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të periudhës kalimtare ose për një periudhë më të gjatë. Periudha e vlefshmërisë së kompensimit është 2 vjet.

Në rast se kontrata ndërpritet sipas Neni 22. dhe Neni 23. me një vendim që shpallë fajtor KSH- në amë, atëherë KSH amë nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim. Megjithatë, KSH amë ka të drejtë të kërkojë mbulimin e koston reale në relacion me shenjëtarin, sipas Neni 23. Paragrafi 2.

Nëse vendimi i Komisionit për regjistrim i FSHSK-së, ka pasur një ndërprerje të kontratës në dëm të klubit amë, klubi amë nuk ka të drejtë për kompensim.

Në rast se kontrata ndërpritet sipas Neni 22. dhe Neni 23. me një vendim që shpallë fajtor shenjëtarin, KSH amë përcakton kompensimin, i cili përbëhet prej:

- kompensimin maksimal me vendim të këshillit drejtues të FSHSK-së, si dhe
- koston reale të klubit amë në relacion me shenjëtarin të bëra deri në momentin e ndërprerjes sëkontratës.

Neni 26.

Për shenjëtaret të cilët nuk janë nën kontratë dhe të cilëve u ka skaduar kontrata, kompensimi përcaktohet në përputhje me neni 23 të paragrafit 2 të kësaj rregulloreje.

E drejta për ankesë

Neni 27

Në qoftë se palët e interesuara konsiderojnë se në procesin e dhënies së fletë lëshimit, me refuzimin e kërkesës për lëshimin e shenjëtarit nga klubi në klubin janë bërë shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje apo kushteve të kontratës mund të ankohet në Komisionin për regjistrim të FSHSK-së, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimin të vendimit.

Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, do të vendos për ankesën brenda tri (3) ditëve nga marrja e ankesës me vendim me shkrim me një shpjegim dhe duhet ta dorëzojë palëve të interesuara. Si datë e deponimit të ankesës, llogaritet data e vulës postare të depozitimit të regjistruar në postë ose data e vërtetimit nga personi zyrtar i FSHSK-së.

Neni 28.

Në vendim të Komisionit për regjistrim të FSHSK-së, pala e pakënaqura mund të ankohet në këshillin drejtues të FSHSK-së, si një shkallë më e lartë, brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i vendimit.

Këshilli drejtues është i obliguar që, brenda 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimin të ankesës, të nxjerr një vendim me shkrim me shpjegimin e paraqitur për palët e interesuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Këshilli Drejtues do të marr parasysh dëshmitë të cilat i janë dorëzuar Komisionit të FSHSK-së për regjistrim. Këshilli Drejtues do të pranojë dëshmi të reja, vetëm nëse pala ankuese mundet të dëshmojë se ato dëshmi nuk kanë qenë në dispozicion në kohën e paraqitjes së ankesës, apo, nëse dëshmitë janë paraqitur ndërmjet dy afateve.

Si datë e deponimit të ankesës, llogaritet data e vulës postare të depozitimit të regjistruar në postë ose data e vërtetimit nga personi zyrtar i FSHSK-së.

Vendimi i këshillit drejtues të FSHSK-së, është përfundimtar.

Neni 29.

Në rastin e vendimit, Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, apo këshilli drejtues i FSHSK-së, afatin mund përjashtimisht ta lëvizë dhjetë (10) ditë, vetëm për të marrë provat e nevojshme.

E drejta për pjesëmarrje

Neni 30.

Gjatë afatit kalimtar, deri në vendimin përfundimtar për miratimin e kërkesës për kalim, shenjëtari mund të marrë pjesë në garat e shenjëtarisë, si anëtar i klubit amë.

Neni 31.

Në rastin e kalimit të shenjëtarit nga njëri klubi në klubin tjetër, në ditën e marrjes së vendimit të komisionit për regjistrim të FSHSK-së, me miratimin e kërkesës për kalim të shenjëtarit nga njëri klubi në klubin tjetër, shenjëtari fiton të drejtën të garoj për klubin e ri.

Shkuarja jashtë vendit

Neni 32.

Shenjëtari, anëtar i klubit të FSHSK-së, në përputhje me procedurën e ISSF dhe ESC mundet, të regjistrohet në një klub të shenjëtarisë sportive në një shtet tjetër që është anëtar i ISSF dhe ESC, në çdo periudhë të vitit kalendarik.

Regjistrimi për një klub të shenjëtarisë sportive të një shteti tjetër anëtar i ISSF dhe ESC mund

të jetë edhe e dyanshme (dyfishtë). Në rastin e regjistrimit të dyanshëm, shenjëtari ka të drejtë pjesëmarrjes në gara për klubin në Kosovë në bazë të propozimeve të garave të FSHSK-së.

Neni 33

Shenjëtari i paraqet kërkesën komisionin për regjistrim të FSHSK-së, për kalim në klub jashtë vendit. Me kërkesë duhet të dorëzoj edhe:

- pëlqimin e klubit amë për të shkuar jashtë vendit:

- pëlqimi duhet të përmbajë një kërkesë për kaluar me ose pa kompensim;
- pëlqimi në kuptim të regjistrimit të dyfishtë ose jo;

- kërkesën e klubit të huaj dhe miratimi i Aleancës-Federatës klubi i të cilës është anëtarë për kalim të shenjëtarit.

Neni 34.

Vendimin për miratimin e kalimit të shenjëtarit për një klub jashtë vendit e bie Komisioni për regjistrim i FSHSK-së, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e kërkesës

Neni 35.

Shenjëtari është i detyruar që në kontratë me klubin e huaj të shenjëtarisë sportive të futë edhe dispozitat e mëposhtme:

- që është i obliguar ti përgjigjet ftesës së selektorit të FSHSK-së, pa kushte për ekipin kombëtar të Kosovës në të gjitha garat zyrtare;
- se klubi i tij jashtë vendit bartë shpenzimet e ardhjes dhe largimit për ftesat në reprezentacion;

Dispozitat përfundimtare

Neni 36.

Interpretimin e kësaj rregulloreje e jep Këshilli drejtues i FSHSK së.

Neni 37.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të FSHSK-së. Në vitin e miratimit të kësaj Rregulloreje, përllogaritja e afateve sipas Nenit 4. fillon 10 ditë pas miratimit. Dita e njëmbëdhjetë, do të llogaritet si dita e parë e afatit kalimtar.

Prishtinë 11.11.2022

Kryetari i FSHSK-së

Gëzim Hazrolli

